

LIGJ
Nr. 10/2013

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9947, DATË 7.7.2008 “PËR PRONËSINË INDUSTRIALE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj fjalët “Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut” zëvendësohen me fjalët “Inspektorati që mbulon fushën e mbikëqyrjes së tregut”.

Neni 2

Në nenin 199, pika 1 ndryshohet si më poshtë:
“1. Çdo veprim i kryer në kundërshtim me përcaktimet e neneve 36, 127, 156 e 178 të këtij ligji, për shkelje të të drejtave të pronësisë industriale, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me dënim kryesor me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë. Gjrobat vendosen nga inspektorati që mbulon fushën e mbikëqyrjes së tregut.”.

Neni 3

Pas nenit 199 shtohet neni 199/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 199/1
Ankimi

Ndaj vendimit të inspektoratit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.”.

Neni 4

Neni 200 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 200

Kontrolli dhe mbikëqyrja e tregut të brendshëm

1. Kontrolli për zbatimin e këtij ligji në tregun e brendshëm bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin nga inspektorati që mbulon fushën e mbikëqyrjes së tregut, pranë ministrisë përgjegjëse për tregtinë.

2. Organizimi dhe funksionimi i këtij inspektorati përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në

krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

Miraturar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 7969, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani